



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-9920/23 datë:19.04.2023



Npi – 01/158 datë: 27.04.2023

Duke u bazuar në nenin, 12.2 shkronja (d), dhe nenin 17 shkronja (i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Rregulloren e (MAPL) Nr.02/2021, për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës; Nenin 53 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Rregulloren e (QRK) Nr.22/2020 për Riintegrimin e personave të Riatdhesuar; Rregulloren e (QRK) Nr.09/2019, për Integrimin e të Huajve (Rregullore miratuar në mbledhjen e 110 të Qeverise së Republikës së Kosovës, me vendimin Nr.01/110, të datës 11.07.2019). Në funksion të zbatimit të Strategjisë për Migrim 2021 – 2025, të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit për miratim Planin Komunal për Riintegrim të qëndrueshëm 2023-25 me numër protokoli Nr.02/237 datë 13.04.2023, prandaj Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 27.04.2023 mori këtë:

V E N D I M

PER MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR RIINTEGRIMIN E QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE INTEGRIMIN E TË HUAJVE NË KOMUNËN E SHTIMES 2023 – 2025

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më: 27.04.2023, unanimisht miratoi, Planin Komunal për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në komunën e Shtimes, 2023 – 2025.

II

A r s y e t i m: Me këtë vendim aprovohet Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Shtimes 2023 – 2025. Në Plan janë përcaktuar: objektivat, masat, veprimet që duhet të merren, prioritetet, institucioni përgjegjës dhe ai mbështetës, afati kohor dhe mekanizmat e tjerë për realizimin e tij. Ky Plan, është hartuar nga Grupi Punues dhe është i përmbledhur, në gjithsej 45 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij vendimi. Për zbatimin e këtij Plani, do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi